

## GJYKATA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

573  
16.07.2009

### Deklaratë për shtyp lëshuar nga Regjistruesi i Gjykatës

#### GJYKIM I DHOMËS

#### FERET kundër BELGJIKËS

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut njoftoi sot me shkrim vendimin e Dhomës së saj në rastin e Féret kundër Belgjikës (ankimi nr. 15615/07). Gjykata votoi me 4 vota kundrejt 3 se **nuk ka pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me dënimin e ankuesit, kryetari i partisë politike "Fronti Kombëtar", për nxitje publikisht të diskriminimit ose urrejtjes, pas ankesave në lidhje me fletushkat e shpërndara nga ajo palë gjatë fushatave zgjedhore. (Vendimi është i disponueshëm vetëm në gjuhën Frengje).

#### 1. Faktet kryesore

Ankuesi, Z. Daniel Féret, është një shtetas belg i cili ka lindur në vitin 1944 dhe jeton në Bruksel. Si kryetar i partisë politike "Fronti Kombëtar-Nationaal Front" ("Fronti Kombëtar") ai është kryeredaktor i publikimeve të partisë dhe pronar i faqes së tij të internetit. Ai ishte anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës në kohën përkatëse.

Ndërmjet muajit korrik të vitit 1999 dhe tetor të vitit 2001 shpërndarja e fletushkave dhe e posterave nga partia e tij, lidhur me fushatat zgjedhore të Frontit Kombëtar, cuan në ankesa nga individë dhe shoqata për urrejtje, diskriminim dhe dhunë, të dorëzuara sipas ligjit të datës 30 korrik 1981 i cili penalizonte disa akte të frymëzuara nga racizmi ose ksenofobia.

Më 19 shkurt të vitit 2002 Z. Féret u morn ë pyetje nga policia në lidhje me ato ankesa.

Imuniteti parlamentar i ankuesit u hoq me kërkesën e Prokurorit Publik kryesor në Gjykatën e Apelit të Brukselit. Në nëntor të vitit 2002 procedura penale u ngritën kundër tij si kryeautor dhe kryeredaktor i fletëpalosjeve fyese dhe pronar i faqes së internetit.

Më 4 qershor 2003, për të gjykuar mbi merita, Gjykata Penale e Brukselit ri-hapi punimet. Ankesa nga Z. Féret lidhur me juridiksionin e kësaj gjykate të shkallës së parë u deklarua e papranueshme në qershor të vitit 2003 dhe në mars të vitit 2004, Gjykata e Kasacionit e

---

Sipas Nenit 43 të Konventës, brenda tre muajve nga data e Gjykimit të Dhomës cdo pale mund, në raste të jashtëzakonshme, të kërkojë që çështja ti referohet Dhomës së Madhe të përbërë nga 17 anëtarë të Gjykatës. Në këtë rast një panel prej pesë gjyqtarësh do të konsiderojë nëse çështja ngre një problem serioz I cili ndikon në interpretimin ose zbatimin e Konventës ose protokolleve të saj, ose një çështje serioze me rëndësi të përgjithshme, rast në të cilin, Dhoma e Madhe do të japë një gjykim përfundimtar. Nëse kërkesa për referim refuzohet, gjykimi i Dhomës do të jepet në formë të prerë pas skadimit të një afati tre-mujor ose më parë nëse palët deklarojnë se nuk synojnë të bejnë kërkesë për referim.

hodhi poshtë ankesën e tij bazuar mbi klauzola të ligjit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.

Më 13 qershor 2004, ankuesi u zgjodh në Këshillin e Qarkut Bruxelles-Capitale dhe në Parlamentin e Komunitetit Francez, të dy pozicionet i ofruan atij imunitet të ri parlamentar.

Prokurori publik rinisi punimet më 23 qershor të vitit 2004. Më 20 shkurt të vitit 2006, Gjykata e Apelit në Bruksel mbajti një gjykim të plotë dhe më 18 prill 2006 e dënoi Z. Féret me 250 orë shërbim komuniteti në lidhje me integrimin e emigrantëve, së bashku me një dënim me 10 muaj burg me kusht. Ajo e deklaroi atë të papranueshëm për dhjetë vjet. Së fundi, ajo e urdhëroi atë që të paguante një euro për secilën palë civile.

Gjykata gjeti se sjellja ofenduese nga ana e z Féret nuk binte brenda veprimtarisë së tij parlamentare dhe se fletëpalosjet përmbanin pasazhe që përfaqësonin një incitation të qartë dhe të qëllimshëm të diskriminimit, segregacionit apo urrejtjes, dhe dhunës, për arsye të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare ose etnike.

Apeli sipas klauzolave të ligjit nga Z. Féret ra poshtë më 4 tetor të vitit 2006.

## **2. Procedura dhe përbërja e Gjykatës**

Ankimi u paraqit në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut më 29 mars 2007. U vendos se pranueshmëria dhe meritat do të vlerësoheshin në të njëjtën kohë.

Gjykimi u dha nga një Dhomë prej shtatë anëtarësh, e përbërë si vijon:

Ireneu **Cabral Barreto** (Portugali), *Kryetar*,  
Françoise **Tulkens** (Belgjikë),  
Vladimiro **Zagrebelky** (Itali),  
Danut **Jo ien** (Lituani),  
Dragoljub **Popovi** (Serbi),  
András **Sajó** (Hungari),  
Nona **Tsotsoria** (Gjeorgji), *gjyqtarë*

dhe gjithashtu Françoise Elens-Passos, Zv. Regjistruer i Seksionit.

## **3. Përmbledhje e Gjykimit<sup>1</sup>**

### **Ankimi**

Bazuar në Nenin 10 (liria e shprehjes), Ankuesi pretendonte se dënimi i tij për përmbajtjen e fletëpalosjeve të partisë së tij politike përfaqësonin një kufizim të tepruar në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes.

### **Vendimi i Gjykatës**

---

<sup>1</sup> Kjo përmbledhje nga Regjistri nuk është detyruese për Gjykatën.

Ndërhyrje në të drejtën e z Féret ndaj lirisë së shprehjes ishte paraparë me ligj (ligji i datës 30 korrik 1981 mbi racizmin dhe ksenofobinë) dhe kishte qëllimet legjitime të parandalimit të çrregullimit të rendit dhe mbrojtjes së të drejtave të tjerëve.

Gjykata vërejti se fletëpalosjet i paraqisnin komunitetet në fjalë si penalisht të të njëjtit mendim dhe të etur për të shfrytëzuar përfitimet që rrjedhin nga jetesa në Belgjikë, dhe se ata gjithashtu kërkonin të talleshin me emigrantët në fjalë, me rrezikun e pashmangshëm, veçanërisht ndërmjet anëtarëve me më pak njohuri të publikut, ndjenjat e mosbesimit, refuzimin apo edhe urrejtjen ndaj të huajve.

Ndërsa liria e shprehjes ishte e rëndësishme për të gjithë, ajo ishte veçanërisht e tillë për një përfaqësues të zgjedhur të popullit: ai ose ajo përfaqësonte elektoratin dhe mbronte interesat e tyre. Megjithatë, Gjykata përsëriti se ishte vendimtare për politikanët, që kur të shpreheshin në publik, të shmangnin komentet që mund të nxisnin intolerancën.

Ndikimi i diskursit racist dhe ksenofobik u madhërua në një kontekst zgjedhor, në të cilin argumentet natyrisht u bënë më të forta. Rekomandimi i zgjidhjeve për problemet e emigracionit duke mbrojtur diskriminimin racor kishte të ngjarë të shkaktonte tensione sociale dhe të prishte besimin në institucionet demokratike. Në rastin në fjalë kishte pasur një nevojë bindëse sociale për të mbrojtur të drejtat e komunitetit të emigrantëve, ashtu sic kishin bërë gjykatat belge.

Përsa i përket dënimit të vendosur mbi z Féret, Gjykata vuri në dukje se autoritetet kishin preferuar një periudhë 10-vjeçare të mosgjedhshmërisë dhe jo një opsion penal, në përputhje me parimin e Gjykatës të kufizimeve në procedurat penale.

Prandaj, Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur shkelje të Nenit 10.

Gjykata shtoi se pjesa tjetër e ankimit ishte e papranueshme.

Gjyqtarët Sajó, Zagrebelsky dhe Tsotsoria shprehën një mendim të përbashkët të kundërt, i cili i është aneksuar gjykimit.

\*\*\*

Vendimet e Gjykatës mund të gjenden në faqen e saj të internetit (<http://www.echr.coe.int>).

### **Kontakte shtypi**

**Céline Menu-Lange (telefon : 00 33 (0)3 90 21 58 77)**

Stefano Piedimonte (telefon : 00 33 (0)3 90 21 42 04)

Tracey Turner-Tretz (telefon : 00 33 (0)3 88 41 35 30)

Kristina Pencheva-Malinowski (telefon : 00 33 (0)3 88 41 35 70)

Frédéric Dolt (telefon : 00 33 (0)3 90 21 53 39)

*Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u krijua në Strasburg nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës në vitin 1959 për trajtimin e shkeljeve të pretenduara të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950.*